



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. 2495 / prot

Koplik më: 01/09 / 2022

V E N D I M

Nr 39 datë 31/08/2022

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 31.08.2022, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë" seksioni 3 neni 14, neni 15 pika 1/a, pika 2/b, neni 16/1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

VENDOSI

1. T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. Prekë Gjok Kalaj (pas vdekjes) me motivacionin:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si arsimtarë dhe drejtues i dalluar në shumë shkolla dhe institucione të pushtetit lokal, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 31.08.2022

Vota Pro 21

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.09.2022





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr 2495 .prot

Koplik më: 30/08/2022

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe
Propozim për dhënie titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e
Madhe z. Prekë Gjok kalaj (pas vdekjes)



Prekë Gjok Kalaj lindi me 13.9.1948 në fshatin Kamicë, Nj.A.Qëndër, Bashkia Malësi e Madhe. Arsimin fillorë e më pas e ka mbaruar në vendlindjen e tij. Ne vitin 1966 ka mbaruar shkollën Pedagogjike Shkoder. Nga viti 1966-1967 ka punuar mesues në Rapshë. Ka mbarua Shkollën e Lartë Shkoder Dega histori-gjeografi ne vitin 1977. Nga viti 1970-1972 ka punua mesues në fshatin Kamicë. Nga viti 1972-deri në prillë të vitit 1983 ka punuar drejtor shkollat ne Bogë. Nga viti 1983 deri ne vitin 1992 ka punuar Kryetar i keshillit te bashkuar Koplik. Me 1 Tetor 1992 deri me 17 Nentor 2003 ka punuar mesues ne Shkollen e Mesme "Dod Kaçaj" Bajzë dhe në Shkollën e Mesme "Sherif Hoxhaj" Koplik. Ne vitin 2003 eshte zgjedhur Nënkryetar i Bashkise Koplik. Me 20 Janar 2005 deri me 27 Maj 2011 ka jetuar ne Amerike deri sa nderroi edhe jete me 27.05.2011.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e Madhe me
motivacion:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si arsimtarë dhe drejtues i dalluar në shumë shkolla dhe institucione të pushtetit lokal, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

